

## **MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË AUTORITETIN RRUGOR SHQIPTAR**

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Autoritetin Rrugor Shqiptar, për projektin “Ndërtimi i rrugës Levan-Tepelenë”, me objekt “Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare” për periudhën nga 01.01.2011 deri 31.12.2013, dhe masat për përmirësimin e gjendjes janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 167 datë 15.12.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 “Për kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 1/6/2000, me shkresën nr. 689/5 datë 15.12.2014, dërguar Z. Dashamir Xhika, Administrator i Autoritetit Rrugor Shqiptar, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

**1.** Nga auditimi i projektit “Ndërtimi i rrugës Levan-Tepelenë”, ka rezultuar se disbursimet kanë qenë në nivele të ulëta. Për këtë arsye është kërkuar shtyrja e afatit të përfundimit të projektit. Ritmi i ulët i disbursimeve dhe vonesa në përfundimin e projektit, ka ndikuar dhe po ndikon në vënien me vonesë në eficiencë të projektit, duke mos marrë në kohën e duhur përfitimet e pritshme nga investimi.

Për këtë rekomandojmë:

***Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe Njësia e Menaxhimit të Projektit të marrin masa për të zbatuar me përpikmëri, në kohë dhe në cilësi të gjitha angazhimet që rrjedhin nga Marrëveshjet e huasë për financimet e projekteve në lidhje me mënyrën e raportimit të donatorët, ritmet e disbursimeve, për të realizuar objektivat dhe komponentët e projektit.***

*Në vazhdimësi*

**2.** Nga auditimi rezultoi se, nga përdorimi i llogarisë speciale në bankën e nivelit të dytë janë përfituar interesa në vlerën 30,135.82 Euro dhe nga shitja e dokumentacionit të tenderëve të projekteve të tjera është përfituar vlera 16,741.52 Euro. Këto vlera duhet të transferoheshin në llogarinë e Qeverisë. Nga auditimi rezulton se shuma e mësipërme nuk është transferuar e plotë, por me vlerë 28,536.32 Euro, ngelet për t’u transferuar vlera 12,641.75 Euro.

Për këtë rekomandojmë:

***Njësia e Menaxhimit të Projektit të marrë masa për derdhjen në llogarinë e Qeverisë të vlerës 12,641.7 Euro, interesa të përfituara nga llogaria e projektit.***

*Menjëherë*

**3.** Si pasojë e ndryshimeve të shumta të projektit, vlera e kontratës nr. 2 (Damës-Tepelenë), nga 27,932,628.41 Euro është rritur në vlerë 33,811,034.3 Euro ose 8.3 %. Ndryshimet janë bërë si pasojë e Projektit të zbatimit i cili është miratuar në vitin 2004 dhe nuk parashikonte ndërprerjet me linjat e energjisë elektrike të ujit të pijshëm dhe të gazit, po ashtu si pasojë e kushteve të terrenit të paparashikuara. Janë bërë ndryshime të cilat kanë afektuar pjesën më të madhe të rrugës, ndërkohë që në një segment me gjatësi rreth 3 kilometër akoma nuk kanë filluar punimet për rikonstruksionin e saj.

Për këtë rekomandojmë:

***Për projekte zbatimi të cilat kanë një diferencë të konsiderueshme kohe nga hartimi deri në stadin e miratimit të marrëveshjes se financimit, Autoriteti Rrugor Shqiptar të marrë masa që gjatë procesit të prokurimit të shërbimeve konsulente, të përfshijë në propozimet financiare dhe teknike rishikimet e nevojshme të tyre.***

*Në vazhdimësi*

**4.** Për kontratën “Ndërtim i segmentit Levan-Damës, janë realizuar ndryshime të konsiderueshme të projektit bazë, të ndikuara nga kushte të paparashikuara të projektit origjinal, si pasojë e të cilave, vlera e kontratës është rritur me 11,942,948.3 Euro, ose 37.8 %.

Ndryshimet e projektit të rrugës kanë afektuar rreth 65 % të gjatësisë së saj, ndërsa për veprat e artit rreth 75 % e tyre, shtuar ose vendosur të mos ndërtohen, kjo kryesisht për defekte të konstatuara në hartimin e projektit origjinal, parametrave të paparashikuar të terrenit, etj.

Parashikimet e projektzbatimit nuk kanë përfshirë zgjidhjet më optimale, madje shumë elementë të dukshëm si psh. spostimi i linjave të tensionit të lartë, spostimi i linjave të ujësjellësit, nuk janë përfshirë në punimet e domosdoshme për ndërtimin e kësaj rruge.

Realizimi i punimeve pa realizuar një garë kompetitive siç mund të bëhej në rastin e parashikimit në projektin origjinal, më tej pjesë e dokumenteve të tenderit, ka bërë që këto punime të realizohen me çmimet e tregut, pasi konkurrimi për to, në rastin e ndryshimeve mund të bëhet me minimumi paraqitjen e ofertës minimumi nga 3 operatorë. Po ashtu, bazuar në pikën 13.5 (b), të kushteve të veçanta të kontratës, për çdo punim që realizohet i cili nuk është parashikuar në kontratë, pas paraqitjes së ofertave për realizimin e tyre, kontraktori përfiton 10 % të vlerës së tyre, duke rritur në këtë mënyrë koston e projektit.

Këto mangësi janë konstatuar në përgjithësi edhe nga auditimi i projekteve të tjera që menaxhohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar, megjithatë nuk janë marrë masat e duhura në këtë drejtim.

Për këtë rekomandojmë:

***Autoriteti Rrugor Shqiptar të marrë masa që gjatë hartimit të projekteve të kërkojë nga njësitë e pushtetit vendor apo entitete të ndryshme hartat e azhurnimit të rrjeteve të telefonisë, energjisë elektrike, ujit të pijshëm dhe kanalizimeve, të gazit etj., për të mundësuar hartimin e projekteve me saktësi dhe shmangien e ndryshimeve gjatë zbatimit të tyre.***

*Në vazhdimësi*

**5.** Urdhër ndryshimi nr. 1, i kontratës së ndërtimit të segmentit Damës-Tepelenë, ka të bëjë me kërkesën e ARSH për rritjen e nivelit të rrugës mbi atë të nivelit të digës së re të Kalivaçit nga km 13.5 deri km 17.750. Niveli i rrugës i parashikuar në projektin bazë në këtë seksion arrin deri në 96 m mbi nivelin e detit, ndërsa kuota e liqenit, pas ndërtimit të digës së HEC Kalivaç është projektuar 112 m mbi nivelin e detit. Në dokumentacionin mbështetës të këtij urdhër ndryshimi përcaktohet se gjatë hartimit të projektit origjinal të kësaj rruge, ka qenë i njohur fakti i realizimit të studimit të fizibilitetit për ndërtimin e digës mbi Lumin Vjosë, në të cilin kuota normale e liqenit është projektuar 112 m mbi nivelin e detit. Megjithatë, duke parë paqartësinë e natyrën e këtij projekti është vendosur që projekti paraparak të mos merrte në konsideratë këtë fakt. Punimet në HEC-in e janë ndërprerë për një kohë të gjatë dhe nuk ka informacion mbi stadin e punimeve dhe statusin e koncesionit. Nga auditimi konstatohet se nuk bëhet punë e mjaftueshme dhe se nuk ka një rakordim ndërmjet institucioneve, në lidhje me ideimin, planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e projekteve me financime të huaja.

Për këtë rekomandojmë:

***Autoriteti Rrugor Shqiptar të marrë masa të vazhdueshme dhe të hartojë një database të veprave në ndërtim apo në fazë fizibiliteti, të cilat ndikojnë në stabilitetin apo ndërpresin rrjetin rrugor në administrim të tij, me synim shmangien e problematikave që çojnë në ndryshime të projekteve të cilat shoqërohen me rritje kostojë, apo ndërprerje të punimeve. Po ashtu, Njësia e Menaxhimit të Projektit të marrë konfirmimet e duhura nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, mbi statusin e Hidrocentralit të Kalivaçit, në mënyrë që të merren masat e duhura për fillimin e punimeve në segmentin me gjatësi 3 kilometër, pjesë e segmentit rrugor Damës-Tepelenë, pezulluar për arsye se niveli i ujit të HEC-it, përmbyt këtë segment rrugor sipas vijës së projektit të miratuar.***

***Në vazhdimësi***

**6.** Nga auditimi ka rezultuar se në segmentin rrugor Levan-Damës, është ndërtuar rrethim anësor (guardrails) vetëm në gjatësinë 14 kilometër, nga gjatësia prej 35 kilometër i këtij segmenti rrugor. Duke marrë në konsideratë faktin se gjatë këtij segmenti rrugor ka banesa të shumta dhe zhvillime bujqësore, rezulton se sasia e vendosur është e pamjaftueshme, për arritjen e parametrave optimal të sigurisë.

Për këtë rekomandojmë:

***Autoriteti Rrugor Shqiptar të rendisë në prioritetet e tij, duke parashikuar fondet e nevojshme për mbulimin në një sasi më të madhe me rrethim (guardrails) të superstradës Levan-Tepelenë, me qëllim rritjen e sigurisë në transportit të automjeteve në të.***

***Brenda muajit mars 2015***

**7.** Gjatë zbatimit të kontratës “Ndërtimi i segmentit rrugor Levan-Damës”, por edhe segmentit tjetër “Damës-Tepelenë”, ka rezultuar se procesi i shpronësimit nuk ka ecur siç duhet. Për këtë arsye, Kompanitë ndërtuese kanë paraqitur një sërë pretendimesh, të cilat kanë të bëjnë me vonesa të shkaktuara nga ky proces.

Për këtë rekomandojmë:

***Autoriteti Rrugor Shqiptar të marrë masat e duhura në kohë për realizim të shpejtë dhe eficient të procesit të shpronësimeve, për shmangien e ndërprerjeve, pezullimeve apo vonesave në zbatimin e kontratave të punimeve, të cilat çojnë në rritje të kostos së projekteve, vënie me vonesë në eficiencë dhe mos arritje të objektivave të parashikuara në afat.***

***Në vazhdimësi***

**8.** Bazuar në programin e paraqitur nga zbatuesi i punimeve, punimet duhet të përfundonin brenda datës 28.02.2014. Përfundimi i punimeve është shtyrë deri me datë 30.06.2014. Duke qenë se ky afat ka përfunduar, duhet të përlllogaritet afati i përfundimit dhe vënies në eficiencë të plotë të rrugës, duke rritur angazhimin e punonjësve dhe makinerive të kontraktorit.

Për këtë rekomandojmë:

***Njësia e Menaxhimit të Projektit dhe Konsulenti, t'i kërkojnë Kontraktorit paraqitjen e një programi të punimeve për rishikim, me synim rritjen e angazhimit dhe përfundimin sa më parë të punimeve të kontratës.***

***Menjëherë***

9. Nga auditimi i zbatimit të kontratave të punimeve civile sipas këtij projekti ka rezultuar se, krijohen vonesa të shumta në vënien e territorit për realizimin e punimeve nga kontraktorët. Po ashtu, kanë rezultuar ndërprerje të shumta të punimeve, ku si pasojë, kontraktorëve u lind e drejta për përlllogaritjen e pretendimeve për shtesë afati të përfundimit si dhe kosto shtesë.

Për këtë rekomandojmë:

*Autoriteti Rrugor Shqiptar të marrë masa të vazhdueshme për sigurimin e aksesit të kontraktorëve në objektet në ndërtim, me qëllim shmangien e vonesave dhe ndërprerjeve të punimeve të cilat ndikojnë negativisht në performancën e projekteve dhe tejkalim të afatit të përfundimit të punimeve i cili shoqërohet me:*

*- Paguesa për rishikimin e çmimeve përtej atyre të parashikuara.*

*- Lindjen e pretendimeve të kontraktorëve për shtesë në afatin e përfundimit të punimeve si dhe shtesë kostoje.*

*- Vonesa të futjes në eficiencë të investimit.*

*- Ulje të përfitimeve të pritshme të përlllogaritura nga investimi.*

*- Mos arritje në kohë të qëllimit dhe objektivave të projektit.*

*Në vazhdimësi*

## **B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

1. Pas falimentimit të Firmës “████████”, me datë 05.09.2013, është nënshkruar kontrata për përfundimin e punimeve të mbetura me Kontraktorin “████████” Sh.p.k me vlerë 5,557,498.12 Euro, për segmentin “Damës-Tepelenë”. Referuar artikullit 5 të kontratës, afati i përfundimit të punimeve duhet të përcaktohej sipas grafikut të cilin kontraktori duhet ta paraqiste brenda 15 ditëve nga nënshkrimi i kontratës. Përfundimi i punimeve është shtyrë deri me datë 30.06.2014. Pas kësaj date, nga ana e konsulentit nuk është bërë njoftimi për fillimin e aplikimit të penalteteve për vonesa. Për periudhën nga data 30.06.2014 deri me datë 30.09.2014, bazuar në kushtet e kontratës origjinale Pika 8.7 dhe 14.15 (b), për vonesa në përfundimin e punimeve, kontraktori duhet të njoftohej për penalitete me vlerë 250,057.1 Euro.

Kjo kontratë nuk përfshin punimet për ndërtimin e rrugës nga kilometër 26.050 deri kilometër 30.150., pasi për këtë seksion Kontraktori “████████” Sh.p.k ka nënshkruar kontratë me Kontraktorin “████████”, para falimentimit, me vlerë 5,986,676.12 Euro. Punimet sipas kësaj kontrate duhet të përfundonin me datë 13.12.2013.

Për vonesa në përfundimin e punimeve edhe për këtë kontratë, kontraktorit nuk i është bërë asnjë njoftim. Sa më sipër, për periudhën nga data 30.06.2014 deri me datë 30.09.2014, bazuar në kushtet e kontratës origjinale Pika 8.7 dhe 14.15 (b), për vonesa në përfundimin e punimeve, kontraktori duhet të njoftohej për penalitete me vlerë 269,400 Euro.

Theksojmë se edhe kontraktori ka paraqitur pretendime për vonesa të shkaktuara nga kushtet e papërshtatshme të motit, ndërprerje të punimeve nga banorë të zonës për shpronësime etj., por nga konsulenti deri në fazën e auditimit nuk janë bërë llogaritje për vlerësimin e tyre.

Për këtë rekomandojmë:

***Mbikëqyrësi i Punimeve Kompania “████” si dhe Njësia e Menaxhimit të Projektit, të marrin masa për aplikimin e penaltetit me vlerë 519,457 Euro për Kontraktorin “████” Sh.p.k, për mos përfundim në afat të punimeve si më poshtë:***

- Për kontratën e punimeve të mbetura pa u realizuar nga falimentimi i kontraktorit “████”, vlera e penaltetit për vonesa referuar datës së parashikuar për përfundim deri në momentin e auditimit është 250,057.1 Euro.

- Për kontratën e punimeve të segmentit rrugor nga kilometër 26.050 Euro deri kilometër 30.150, vlera e penaltetit për vonesa referuar datës së parashikuar për përfundim deri në momentin e auditimit është 269,400 Euro.

Gjithashtu, mbikëqyrësi i punimeve të marrë masa për përlogaritjen dhe vlerësimin e pretendimeve të kontraktorit për vonesa të shkaktuara nga ngjarje të paparashikuara, kushte të papërshtatshme të motit, vonesa nga ndryshimet e projektit, vonesa nga mos realizimi në kohë i shpronësimeve etj.

### ***Në fazën përmbyllëse të kontratave***

2. Nga auditimi rezulton se zëri A. 208 “Mirëmbajtje dhe operim i laboratorit” është likuiduar me vlerë 5,520 Euro, ndërkohë që nga auditimi i dokumentacionit të korrespondencave rezulton se laboratorit nuk është vënë në funksionim.

- Nga verifikimi i dokumentacionit të pagesave të certifikatës progresive të punimeve rezultoi se Kontraktorit “████” Sh.p.k, është likuiduar padrejtësisht për punime të pa realizuara si më poshtë:

-Për këtë zërin e punimeve C. 312 “Mbjellje akacie” është likuiduar më shumë vlera 178,080 Euro.

- Nga verifikimi i punimeve sipas zërit G.405 “Furnizim dhe vendosje shenja rrugore bojatisje në gjerësi të ndryshme” (sinjalistikë horizontale), është likuiduar më shumë vlera 14,440.4 Euro.

Nga verifikimi i punimeve sipas zërit G.401.a “Furnizim dhe vendosje shenja rrugore bojatisje me gjerësi 150 mm në anët e asfaltit” (sinjalistikë horizontale), është likuiduar më shumë vlera 23,219.8 Euro.

Nga verifikimi i punimeve sipas zërit G. 402. a “Furnizim dhe vendosje shenja rrugore bojatisje në gjerësi të ndryshme” (sinjalistikë horizontale), është likuiduar më shumë vlera 12,794.9 Euro  
Për këtë rekomandojmë:

***Mbikëqyrësi i Punimeve, të marrë masat e nevojshme për zbritjen në certifikatën pasardhëse të punimeve vlerën 228,535.1 Euro, përfituar padrejtësisht nga Kontraktori “████” sh.p.k, për punime të certifikuara por të pa realizuara si më poshtë:***

- Sipas zërit A. 208 “Mirëmbajtje dhe operim i laboratorit”, pagesa me vlerë 6624 Euro.

- Sipas zërit C. 312 “Mbjellje akacie” me vlerë 178,080 Euro.

- Sipas zërit G. 405 “Furnizim dhe vendosje shenja rrugore bojatisje në gjerësi të ndryshme”, me vlerë 14,440.4 Euro.

- Sipas zërit G. 401. a “Furnizim dhe vendosje shenja rrugore bojatisje me gjerësi 150 mm në anët e asfaltit”, me vlerë 23,219.8 Euro.

- Sipas zërit G. 401. a “Furnizim dhe vendosje shenja rrugore bojatisje me gjerësi 150 mm në anët e asfaltit”, me vlerë 12,794.9 Euro.

***Gjatë miratimit të certifikatës progresive të punimeve***

## C. MASA ADMINISTRATIVE

Autoriteti Rrugor Shqiptar të klasifikojë si të papranueshëm për nënshkrimin e kontratave të mëtejshme për shërbime konsulente, Kompaninë “██████████”, sepse nga auditimi i kontratave të punimeve civile, kanë rezultuar mangësi si më poshtë:

Nuk ka bërë njoftimet përkatëse për aplikimin e penaliteteve për vonesa në përfundimin e punimeve, me vlerë 519,457 Euro.

Nga verifikimi i punimeve të kontratave ka rezultuar se, janë realizuar pagesa për punime të pa realizuara si më poshtë:

- Sipas zërit A. 208 “Mirëmbajtje dhe operim i laboratorit” është likuiduar me vlerë 5,520 Euro, ndërkohë që nga auditimi i dokumentacionit të korrespondencave rezulton se laboratori nuk është vënë në funksionim.

-Për këtë zërin e punimeve C. 312 “Mbjellje akacie” është likuiduar më shumë vlera 178,080 Euro.

- Nga verifikimi i punimeve sipas zërit G.405 “Furnizim dhe vendosje shenja rrugore bojatisje në gjerësi të ndryshme” (sinjalistikë horizontale), është likuiduar më shumë vlera 14,440.4 Euro.

Nga verifikimi i punimeve sipas zërit G.401.a “Furnizim dhe vendosje shenja rrugore bojatisje me gjerësi 150 mm në anët e asfaltit” (sinjalistikë horizontale), është likuiduar më shumë vlera 23,219.8 Euro.

Nga verifikimi i punimeve sipas zërit G. 402. a “Furnizim dhe vendosje shenja rrugore bojatisje në gjerësi të ndryshme” (sinjalistikë horizontale), është likuiduar më shumë vlera 12,794.9 Euro

*Shënim: Auditimi i krye nga audituesit Artan Topiana, Ina Sokoli, Ludmilla Sula, Pranvera Doçi, më tej u shqyrtua nga k/auditues Mimoza Lloji, Drejtori i Departamentit Xhaferr Xhoxhaj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Sigurimit të Standarteve Ermal Yzeiraj, si dhe u verifikua si praktike nga Sekretari i Përgjithshëm Luljeta Nano.*

## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT